



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndërtesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 1209/1 Prishtinë 23.05 2023

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI HIDROTEKNIK

Studenti **Besart Krasniqi** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “ **Studimi i furnizimit me ujë për objektet e larta nën ndikimin e topografisë dhe meteorologjisë në qytetin e Prishtinës** ” në programin e studimeve Hidroteknik dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

ABSTRAKTI

Ujin e shfrytëzojmë pothuajse në çdo sferë të jetës duke u nisur nga nevojat e përditshme personale e deri te nevojat ekonomike, industriale dhe agrokulturore. Shëndeti i njeriut varet nga pastërtia e ujit, jo vetëm e atij për pije, por edhe nga përdorimi jo i drejtpërdrejtë i tij si për ujitje të mbjellurave në bujqësi, ujitje të kopshteve, kultivim të peshqëve etj.

Ky punim hulumtues me titullin “Studimi i furnizimit me ujë për objektet e larta nën ndikimin e topografisë dhe meteorologjisë në qytetin e Prishtinës”, fokusohet në përgjithësi në përzgjedhjen e sistemit të furnizimit me ujë për qytetin e Prishtinës duke shfrytëzuar topografinë dhe meteorologjinë e vendit. Qëllimi i përgjithshëm i punimit është furnizimi me ujë i objekteve me kuota të larta në mënyrë sa më efektive që të mos paraqiten probleme gjatë funksionimit të rrjetit.

Po ashtu janë analizuar dhe janë përshkruar lokacionet e fabrikave të pastrimit të ujit, rezervuarëve dhe stacioneve të pompimit ekzistues kryesor mbrenda zonës urbane të kryeqytetit, është analizuar konfiguracioni i terenit për vendosjen ideale të rezervuarëve të planifikuar për ndëtim në të ardhmen, rezervuarë të cilët, do të mbulojnë me furnizim të rregullt me ujë zonë e re të ndërtimit.

Për vlerësimin e ndikimit të konfiguracionit, janë marrë për studim pesë objekte të ndryshme me etazhitet dhe me vendodhje në lagje të ndryshme të zonës urbane të qytetit të Prishtinës. Objektet shumëkatëshe të ndërtuara në qytetin e Prishtinës janë të rrezikuara për mungesë të shtypjes jo të mjaftueshme ku për këtë shkak janë edhe objekt studimi.

Rezultatet që priten nga ky punim janë që të fitohen njohuri më të thella në furnizimin me ujë tek objektet e larta afaristobanesore, zgjedhja e drejtë e tipit të pompes për furnizim sa më efektive dhe pa problem, si dhe zgjedhja adekuate e materialeve për evitimin e problemeve që mund të shkaktohen në rrjetin e brendshëm të ujësjellësit.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimitarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimitarisë.